



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË

KRYETARI

URDHËRESË

Nr. 7481, datë 14.02.2019

**MBI ORGANIZIMIN E PLANIT TË LËVIZJES SË AUTOMJETEVE,
MBARËVAJTJES DHE ORGANIZIMIT NË ZBATIMIN E PUNIMEVE
PËR OBJEKTIN "GODINË BANIMI 9 KATE DHE 2 KATE PARKIM
NËNTOKË NË RRUGËN "FAIK KONICA"**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja "b", nenit 25 dhe nenit 64 shkronja "a" të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore"; neni 3, pika 30, nenit 5, pika 3, nenit 7, pikat 1, dhe nenit 37 të ligjit nr. 8378, datë 22.07.1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë" (i ndryshuar); vendimit nr. 153, datë 07.04.2000 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e Rregullores së Zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë" (i ndryshuar) me qëllim, ushtrimin efektiv të funksioneve, kompetencave dhe realizimit të detyrave nga organet e vetëqeverisjes vendore si dhe mbarëvajtjen dhe organizimin e qarkullimit rrugor, sipas kërkesës së ardhur me nr. 47556, date 26.12.2018 mbështetur në lejen e ndërtimit Nr. K-3248/3, datë 03.03.2018 miratuar me Vendimin e Kryetarit të Bashkisë,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e qëndrimit dhe kthimin me dy sense levizjeje të rrugës "Faik Konica" në segmentin nga rruga "Gjeneral Nikols" deri në kantierin e punimeve "Garden Side", në një afat 2 (dy) vjeçar.
2. Subjekti "Eurocol" ngarkohet për kompletimin me sinjalistikën e përkohshme të nevojshme.
3. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike, Drejtoria e Përgjithshme Nr. 2 e Punëtorëve të Qytetit dhe Policia Bashkiake në bashkëpunim me Komisionarin Rajonal të Policisë Rrugore për zbatimin e kësaj urdhërese.

Kjo urdhëresë hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Erion Vellaj

